



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1.2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 8767, të datës 20.01.2026 të Elbasan Shoshaj, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 8767, të datës 20.01.2026 të Elbasan Shoshaj, udhëheqës i Sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës në Komunën e Prizrenit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të tij, i cili është diagnostikuar me një sëmundje të rënd, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor) lejohen mjetet financiare në shumën prej 1000.00 € (njëmijë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.